



Datë: 14.07.2025
Numër Protokolli: 4727/2025

A.nr.1155/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosje e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Sabile Avdyli-në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1155/2025 të datës 18.06.2025 të parashtruar nga ankuesja F.B, kundër organit të punësimit/Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 14.07.2025 mori këtë:

V E N D I M

I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **shpallet jo kompetent** për të shqyrtuar dhe vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.1155/2025, të datës 18.06.2025, të parashtruar nga ankuesja F.B.

II. Lënda i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent/Komisionit për Ankesa të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës.

A r s y e t i m

F.B (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), me datë 18.06.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4125/2025, të regjistruar nën shenjën A.nr.1155/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mbi pretendimet ankimore kundër procedurës së rekrutimit të shpallur me datë 30.04.2025 me nr.reference RN00017730 për pozitën Zyrtar i lartë i Personelit në Zyrën e Sekretarit në Akademinë e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës **nuk është kompetent** për të vendosur për ankesën me numër A.nr.1155/2025, të datës 18.06.2025, të parashtruar nga ankuesja, F.B, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesja, ka aplikuar në konkursin e shpallur të datës 30.04.2025, me nr.reference RN00017730 për pozitën Zyrtar i lartë i Personelit në Akademinë e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës.

Tutje, bazuar në Njoftimin të datës 17.06.2025 për përzgjedhjen e kandidatit fitues, ankuesja është radhitur e dyta me gjithsej 81 pikë.

Ankuesja, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se komisioni i pranimit ka bërë shkelje të procedurave të rekrutimit me rastin e zgjedhjes së kandidates fituese, duke theksuar se Komisioni e ka mbivlerësuar, kandidaten fituese.

Kolegji i Këshillit në kuptim të pranueshmërisë së ankesës ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, përkatësisht nenit 5 paragrafi 3 ku përcaktohet se: **3. Nëpunësja/i i shërbimit publik është zyrtarja/i publik i cili ofron shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit, në fushën e mjekësisë ligjore, si dhe shërbime tjera të ngjashme publike. Nëpunësja/i i shërbimit publik ushtron detyrën në pozitën përkatëse duke filluar nga niveli profesional deri në nivelin e lartë drejtues. Nëpunësja/i i shërbimit publik është edhe nëpunësja/i i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike pjesë e administratës shtetërore, në administratën e shërbimeve publike apo pjesë e komunës.**, dhe si rrjedhojë konstatoi se të punësuarit në Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, e cila sipas Ligjit Nr.05/L-038 për Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, ka statut të pavarur në fushën e shkencës dhe artit, që përfshin promovimin, kultivimin, nxitjen dhe zhvillimin e mendimit shkencor dhe të krijimtarisë artistike, andaj edhe nëpunësit e këtij institucioni nuk e kanë statusin e Nëpunësit të Shërbimit Civil, dhe si për rrjedhojë të njëjtit e gëzojnë statusin e **Nëpunësit të shërbimit publik** sikurse përcaktohet me nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Andaj, meqenëse ankuesja nuk e ka statusin e nëpunësit civil, Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në dispozitat e nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent që të shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi që të shpallë veten jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.1155/2025 të datës 18.06.2025, të parashtruar nga ankuesja Fatmire Berisha.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezulton se ankuesja nuk ka parashtruar ankesë brenda organit të punësimit, gjegjësisht e njëjta nuk i ka konsumuar mjetet juridike – administrative, Kolegji i Këshillit, vendosi ashtu që lënda të bartet tek Komisionit për Ankesa të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës në kuptim të dispozitave të nenit 75 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Bazuar si më sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1155/2025

Sabile AVDYLI

Procesmbajtëse

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- *Ankueses F.B;*
- *Udhëheqëses së Personelit në Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës;*
- *Komisionit për Ankesa të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*